

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR

LËNDA: AFTËSIM TEKNOLOGJIK

(Klasa e pestë)

VITI SHKOLLOR 2008-2009

Tiranë, 2007

I. TË PËRGJITHSHME

Lënda e aftësim teknologjik në klasën e pestë të arsimit 9-vjeçar, sipas planit mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, do të zhvillohet në:

35 javë mësimore me 1orë/javë

Gjithsej: 35 javë x 1orë/javë= 35 orë vjetore

Kurrikuli i konceptuar për këtë lëndë, do të zhvillojë përvojat e fituara nga nxënësit në klasat 1-4. Në këtë program njohuritë zgjerohen duke u përshkallëzuar e duke realizuar përforcimin e tyre jo vetëm në drejtimin praktik, por edhe edukativ.

Kurrikuli i lëndës aftësim teknologjik në klasën e pestë, do të thellojë *njohuritë* teorike për bazën materiale, proceset e punës dhe *teknikat* në realizmin e një punimi; do të zhvillojë më tej *aftësitë* e nxënësve për vëzhgimin e elementeve në një punim ose krijim; për përshkrimin dhe interpretimin e karakteristikave të punimit të kryer; për vlerësimin në bazë të njohurive të marra për punën e tyre apo të dikujt tjetër; për të bashkëpunuar, për të punuar në grup, dhe për të përdorur një sasi më të madhe informacioni apo baze materiale; do të zhvillojë gjithashtu më tej *shkathtësi* të nxënësve në drejtim të përdorimit të bazës materiale dhe *qëndrimet* për të qenë i pavarur gjatë një punimi, për të respektuar mendimin e tjetrit, për të marrë përgjegjësi për punën si dhe *vlera* për të respektuar traditat dhe zakonet, për të realizuar detyrat dhe për të marrë përgjegjësi.

Gjatë zbatimit të procesit teknologjik (brenda kuadrit të kurrikulit) numërohen një sërë aftësish që duhet të përjetojë nxënësi. Parashikimi i këtyre të fundit në kurrikul i ndihmon mësuesit në formulimin e qëllimeve të mësimdhënies e vlerësimin e arritjeve.

Tri janë kategoritë kryesore të listuara më poshtë: aftësitë njohëse, aftësitë praktike dhe aftësitë komunikuese.

Aftësitë njohëse: Përcaktimi i problemeve dhe nevojave njerëzore, vëzhgimi, mbledhja e të dhënave, interpretimi i të dhënave të mbledhura, specifikimi i kërkesave që duhet të përmbushë produkti, zgjidhje e problemeve që lidhen me skicimin e produktit, shqyrtimi dhe vlerësimi i zgjidhjes, krahasimi, dallimi, analiza sipas kriterëve, vendimarrja.

Aftësitë praktike: Matja, prerja dhënia e formave, bashkimi dhe montimi, ndërtimi dhe përfundimi; organizimi i zinxhirit të veprimtarive në një sekuencë logjike.

Aftësitë komunikuese: Formulimi i ideve gjatë fazës së skicimit dhe në fazën e paraqitjes së produktit përfundimtar; përgatitja e skicave, diagrameve, modeleve dhe fotografive. Programi ruan deri diku përmbajtjen e mëparshme, por, gjithashtu, synon të shmangë mbingarkesën dhe të ulë nivelin e vështirësive në disa linja, si dhe të realizojë një organizim dhe një shpërndarje më të mirë të orëve sipas linjave.

Ky program është konceptuar në ndihmë të:

- Hartuesve dhe botuesve të teksteve mësimore dhe materialeve ndihmëse të mësuesve;
- Mësuesve, specialistëve të arsimit, prindërve etj.

II. SYNIME TË PROGRAMIT

Në fund të klasës V të ciklit fillor, programi synon:

- Pajisjen e nxënësve me njohuritë e para për kryerjen e vetëshërbimeve dhe të punëve të ndryshme që realizohen në mjedisin e tyre të afërt;
- Formimin e nxënësve me aftësitë elementare për punë, shprehitë praktike për përdorimin e veglave dhe instrumenteve të thjeshta të punës në shërbim të edukimit të tyre politeknik;
- Edukimin e dashurisë për çdo lloj profesioni, nxitjen dhe përforcimin e imagjinatës krijuese të nxënësve.

Programi i aftësimit teknologjik në klasën e pestë synon t'i pajisë nxënësit me:

- *Njohuri* teorike për bazën materiale, proceset e punës dhe teknikat në realizimin e një punimi.
- *Aftësi* për vëzhgimin e elementeve në një punim ose krijim; për përshkrimin dhe interpretimin e karakteristikave të punimit të kryer; për vlerësimin në bazë të njohurive të marra për punën e tyre apo të dikujt tjetër; për të bashkëpunuar, për të punuar në grup, për të dëgjuar dhe për të respektuar mendimin e shokut, duke u aftësuar për të zënë një pozicion dhe për të përdorur një sasi më të madhe informacioni apo baze materiale.
- *Shkathtësi* për përdorimin e bazës materiale.
- *Qëndrime* për të qenë të pavarur gjatë një punimi; për të respektuar mendimin e tjetrit; për të marrë përgjegjësi për punën që po bëjnë.
- *Vlera* për të respektuar traditat dhe zakonet; për të realizuar detyrat dhe për të marrë përgjegjësi.

III. LINJAT E PËRMBAJTJES

Njohuritë teknologjike klasifikohen në katër linja kryesore

- 1. Njeriu dhe shoqëria në teknologji**
- 2. Teknologjia e informacionit dhe komunikimi**
- 3. Teknologjia e materialeve dhe proceseve**
- 4. Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energjia**

Lista dhe emërtimi i linjave do të ruhet deri në fund të arsimit të detyruar. Si pasojë, duke respektuar uniformitetin e terminologjisë, në programet e viteve të para për ndonjë prej linjave mund të ndodhë që, në përgjigje të veçorive psiko-pedagogjike moshore, kuptimi i linjës të jetë më i zgjeruar.

IV. SHPËRNDARJA E ORËVE

Gjithsej	35 orë
Kurrikula zyrtare	30 orë
Kurrikula në dispozicion të mësuesit	5 orë

Linjat	Objektivat	Konceptet	Sasia e orëve
1. Njeriu dhe shoqëria në teknologji	<p>Në këtë linjë nxënësit do të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë rolin e njeriut në shndërrimin e mjedisit nëpërmjet futjes së teknologjive bashkëkohore në dobi të tij. • Të përshkruajnë disa nga veprimet që bëjnë në jetën e përditshme dhe objektet që lidhen me to: <ul style="list-style-type: none"> – Të përshkruajnë rrugën që ndjek uji për të ardhur deri në shtëpi dhe dobia e tij; – Përftimi i sapunit; – Pasta dhe furça e dhëmbëve. • Të përshkruajnë disa nga produktet me të cilat ushqehen në jetën e përditshme (buka, qumështi etj.) <ul style="list-style-type: none"> – Të tregojnë mënyrën e përftimit të 	<p>Teknologji</p> <p>Proces</p> <p>Pastrim</p> <p>Distilim</p> <p>Produkt</p> <p>Nënprodukt</p>	10 orë

	<p>bukës dhe të realizojnë vetë bërjen e saj;</p> <ul style="list-style-type: none"> – Të tregojnë rrugën e përfutimit të qumështit dhe të nënprodukteve të tij; – Të tregojnë prejardhjen e ushqimeve të ndryshme – Të klasifikojnë produktet në bazë të përbërjes së produkteve ushqimore. 		
<p>2. Teknologjia e informacionit dhe komunikimi</p>	<p>Në këtë linjë nxënësit do të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dallojnë tiparet e objektit që do të prodhohet si: forma, gjatësia, gjerësia, lartësia, llojin e materialit dhe mjetet matëse të thjeshta për skicimin e tij. • Të përcaktojnë për qëllime praktike të dhënat që lidhen me tiparet e objektit • Të paraqesin nëpërmjet formës dhe paraqitjes grafike, trupa të thjeshtë gjeometrikë. • Të dallojnë dhe të përshkruajnë sendet ose objektet që na ndihmojnë të mësojmë • Të përshkruajnë disa nga objektet që na ndihmojnë të jemi në kontakt me njëritjetrin. • Të përshkruajnë disa nga sendet që na ndihmojnë të shkëmbejmë informacione me të tjerët 	<p>Formë Gjatësi Lartësi Mjete matëse Skicim Tipar Paraqitje grafike Trup gjeometrik</p> <p>Send\objekt ndihmës</p> <p>Kontakt</p> <p>Shkëmbim informacioni</p>	<p>8 orë</p>

<p>3. Teknologjia e materialeve dhe proceseve</p>	<p>Në këtë linjë nxënësit do të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajnë objektet që ndodhen në mjedisin ku jetojmë (shtëpi, shkollë, dyqane etj.); • Të dallojnë lëndën me të cilën ato janë ndërtuar; • Të flasin për rëndësinë praktike të lëndës së drurit ose të nënprodukteve të tij për jetën e përditshme të njeriut; • Të përmendin disa nga materialet që e zëvendësojnë atë në prodhimin e orendive shtëpiakë ose në shkollë; • Të përmendin disa nga veglat e përpunimit të drurit dhe të përshkruajnë mënyrën e përdorimi të tyre praktik; • Të dallojnë disa nga objektet prej metali që përdorin në jetën e tyre të përditshme dhe të përshkruajnë disa nga karakteristikat e tyre kryesore; • Të përmendin disa nga veglat prej metali që kanë në shtëpi; • Të dallojnë lëndët prej të cilave janë bërë gjërat të cilat veshim (si pambuku, leshi, mëndafshi, lëndët sintetike etj.); • Të përshkruajnë origjinën e tyre dhe rrugën që kanë përshkuar për të ardhur deri në veshjet tona; • Të bëjnë vetë modele të thjeshta veshjesh ose objekte të ngjashme me to. 	<p>lëndë e parë</p> <p>dru</p> <p>metal</p> <p>lesh</p> <p>pambuk</p> <p>mëndafsh</p> <p>lëndë sintetike</p> <p>përpunim</p> <p>përdorim praktik</p> <p>objekt metali</p> <p>vegla metali</p>	<p>8 orë</p>
--	--	---	---------------------

<p>4.Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energjia</p>	<p>Në këtë linjë nxënësit do të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të tregojnë për veglat, pajisjet, makineritë që marrin pjesë në ndërtimin e strukturave të mëdha; • Materialet kryesore që marrin pjesë në sistemin strukturor të disa objekteve të jetës së përditshme; • Mekanizmat, pajisjet e perçinimit, gërshërët metalike, tranxha e dorës, forcat që veprojnë në to; • Të bëjnë vete skica të thjeshta të ndërtimit të strukturës së disa prej objekteve me të cilët janë në kontakt në jetën e përditshme. 	<p>vegla pune makineri materiale strukturë mekanizëm forcë pajisje skicë</p>	<p>4 orë</p>
---	--	--	---------------------

V. KURRIKULA E LIRË

Qëllimi i orëve të lira (rreth 15% e orëve totale) është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me kërkesat e programit zyrtar të lëndës, miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të lëndës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, Drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës në funksion të objektivave të programit të lëndës në vecanti, por edhe të lëndëve të tjera.

Për mbushjen e tyre me material mësimor mund të përdoren burime të ndryshme.

Organizimi i ekskursioneve në natyrë, të shoqëruara me veprimtari praktike; organizimi i vizitave në qendra të ndryshme prodhimi të shoqëruara me vrojtime dhe të pasuara me detyra; në ferma në shërbim të një objekti të paracaktuar; organizimi i konkurseve brenda klasës edhe për një kapitull; lojëra të ndryshme zbavitëse me elementë që zhvillojnë të menduarin logjik dhe kritik; përforsimi i njohurive të shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënësve ashtu edhe mësuesin, janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

VI. INTEGRIMI

Rëndësi të madhe ka që lënda të lidhet edhe me mësimet e lëndëve të tjera. Kështu, gjatë një punimi, nxënësi mund të krijojë duke bërë ndërthurjen me elemente të artit pamor, me muzikën apo me aktrimin. Gjatë zhvillimit të edukimit teknologjik, mund të zbatohen, të konkretizohen dhe të përforsohen njohuri, shprehje, aftësi të marra në lëndë të tjera, si: matematika, artet figurative, dituri natyre etj. Ndërkohë, aftësitë që nxënësit fitojnë, mund të përdoren edhe në mësimin e lëndëve të tjera.

Nxënësit bëhen njohës dhe përdorues jo vetëm të bazës materiale, por edhe të teknikave të ndryshme e të shumëllojshme të proceseve të zbatimit të tyre. Duke u familjarizuar me to, ata do të jenë në gjendje që t'i përdorin ato për zgjedhjet e tyre artistike dhe për të komunikuar ndjenjat dhe mendime.

Është gjithmonë e rëndësishme të theksohen shprehitë e mira të sigurisë. Në të gjithë veprimtarinë gjatë këtyre mësimëve, është e domosdoshme që mësuesi, në përshtatje me temën a punën që do të kryhet, të japë edhe rregullat përkatëse të sigurimit teknik. Nxënësit nxiten të zbatojnë disa rregulla sigurie, të cilat afishohen në këndin e punës së klasës.

Aspektet kros-kurrikulare janë pasur parasysh në shtjellimin e rubrikave të programit. Edhe gjatë zbatimit të tij një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- edukimit mjedisor, ndotjes dhe mbrojtjes së tij;
- kulturës së komunikimit;
- edukimit për të drejtat e njeriut;
- atdhedashurisë (informacion kulturor, ekonomik, social, historik, gjeografik)
- globalizmit
- çështjeve të barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare;

VII. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Programi është konceptuar në tërësi. Në të jepet sasia orientuese e orëve dhe çështjet kryesore që do të trajtohen.

Numri i orëve në njësi të veçanta mësimore planifikohet nga mësuesi ashtu si ai e sheh të arsyeshme në përputhje me kushtet e shkollës dhe të nxënësve të tij, por është kusht që të respektohet në total numri i orëve të planifikuara për secilën nga linjat mësimore të përcaktuara në këtë program.

Programi ruan deri diku përmbajtjen e mëparshme por, gjithashtu, synon të shmangë mbingarkesën dhe të ulë nivelin e vështirësive në disa linja, si dhe të realizojë një organizim dhe një shpërndarje më të mirë të orëve sipas linjave.

Punët praktike të shoqërohen me vizatime teknike të thjeshta dhe në të paraqitet radha e proceseve teknologjike që ndiqet për prodhimin e objekteve.

Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që për çdo lloj pune nxënësit të marrin njohuritë e para praktike dhe teorike për punimin e objekteve, të mjeteve mësimore dhe të lodrave të thjeshta.

Të mbahet parasysh që në çdo orë mësimi vëmendja kryesore dhe *koha t'i lihet punës së nxënësve*. Pra, teoria shërben vetëm për ta përgatitur nxënësin për të kryer punë të ndryshme.

Programi paraqet llojet e punës të zbërthyera e të gërshetuara, duke marrë për bazë kohën më të përshtatshme për realizimin e çdo objekti, llojin e punës që duhet kryer dhe njohuritë praktike e teorike që ka marrë nxënësi në orët e mëparshme. Mësuesi mund të zgjedhë atë që ai e gjykon më të përshtatshme për nxënësin dhe që realizon të gjitha kërkesat mësimore dhe edukative.

Për zbatimin cilësor të kërkesave të programit, mësuesi të zotërojë mirë lëndën, të zgjerojë vazhdimisht horizontin e tij shkencor e kulturor, të përsosë vazhdimisht metodat e mësimdhënies, të aktivizojë pa ndërprerje mendimin krijues të nxënësve, të punojë me durim, pasion e këmbëngulje.

Gjatë zhvillimit të lëndës duhet të respektohen *parimet dhe rregullat didaktike* që përdoren në mësimet e të gjitha lëndëve të tjera. Të përdoren metoda dhe forma të ndryshme pune: biseda, shoqëruar me përgatitjen analitike të objekteve konkrete, paraqitja e mjeteve për kryerjen teknike të punës me vegla dhe ushtrime të shumta për të përvetësuar mënyrat e reja të punës.

Në fillim të mësimin, nxënësve t'u tregohet *qëllimi konkret i punës*. Për këtë, mësuesi u tregon nxënësve se çfarë objekti do të punohet, përse do të shërbejë ai, çfarë aftësish e shprehish do të fitojnë ata duke punuar këtë objekt. Nxënësve u tregohet objekti i gatshëm, pastaj i zbërthyer në pjesë dhe mënyrat e punimit. Vetë nxënësit mësohen dalëngadalë të kuptojnë paraqitjen grafike të objektit dhe të lexojnë skica të thjeshta të objektit që punohet.

Për të zhvilluar te fëmijët aftësi logjike për të punuar, të nxiten ata të mendojnë dhe të arsyetojnë duke organizuar edhe diskutime në grup për mënyrat e punimit të objektit, *çfarë materialesh dhe veglash nevojiten për punën*, në ç'sasi, pse duhet vepruar kështu. Vëmendja të përqendrohet edhe te shpjegimi për disa gabime që mund të bëjnë gjatë punës. Në rastin e demonstrimit të mbajtjes së trupit gjatë punës, mënyrat e përdorimit të

mjeteve dhe të veglave të punës, është mirë të përdoren edhe *mjete demonstruese* në klasë. Për t'u siguruar nëse nxënësit i kanë kuptuar mirë veprimet e punës, ngrihet ndonjë nxënës që të tregojë si do t'i kryejë ato. Në këtë rast, mësuesi vë në dukje veprimet e mira të nxënësit, qorton gabimet e mundshme në përdorimin e veglave dhe i udhëzon fëmijët për fillimin e punës.

Rëndësi të madhe ka zhvillimi te nxënësit i elementeve të shprehive të konstruktimit, zhvillimi i përfytyrimeve të hapësirës etj. Të ushtrohen ata sistematikisht që të bëjnë matje të thjeshta, të verifikojnë përpjesëtimet, të studiojnë vendosjen reciproke të pjesëve të ndryshme të objektit që punohet.

Për të edukuar te fëmijët shprehitë e një pune të kulturuar, për të ngulitur te ta ndjenjën e përpikërisë, të rregullit e të higjienës vetjake, rëndësi ka përgatitja dhe *rregulli në vendin e punës*. Për çdo mjet pune dhe material, gjatë gjithë kohës së punës, caktohet vendi përkatës, si është vepruar që në klasat paraardhëse, në tavolinë ose në bankë.

Gjatë punës së pavarur mësuesi ndihmon, duke kontrolluar me kujdes veprimtarinë e çdo nxënësi, kërkon që ata të zbatojnë saktë udhëzimet e tij, të mbajnë trupin drejt gjatë punës, të përdorin drejt mjetet, të mbajnë pastër vendin e punës etj. Rëndësi ka dhe organizimi i punës me grupe.

Puna me grupe mund të organizohet, në punimin e objekteve të zbulimit për festa, modelime, ndërtime të ndryshme shumëplanëshe, makete etj. Gjatë kësaj pune realizohet ndarja e punës ndërmjet nxënësve dhe ata bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, duke kryer punët që u ngarkohen dhe duke mbajtur përgjegjësi për punën e kryer.

Një nga shqetësimet e para të mësuesit është *organizimi i klasës*. Për një orë mësimi të kihen parasysh disa faktorë:

- hapësira në klasë ku do të zhvillohet veprimtaria;
- sigurimi i materialeve;
- madhësia e klasës;
- numri i fëmijëve që kërkojnë hapësirë pune.

Ka rëndësi që çdo fëmijë të ketë hapësirën e nevojshme për punë. Nëse fëmijët marrin pjesë në një krijim të madh, krijohet hapësirë e nevojshme për materialet. *Materialet të jenë të dukshme e të gatshme për përdorim nga fëmijët*.

Për t'i stërvitur nxënësit në kryerjen dhe përvetësimin e disa veprimeve të rëndësishme në punë ose në përdorimin e metodave të punës, mësuesi të vazhdojë të japë herë pas here edhe detyra shtëpie.

Për të zgjeruar horizontin politeknik, rëndësi ka krahasimi i mënyrave të punimit të objekteve në klasë dhe në prodhim. Në këtë drejtim, vlerë të madhe kanë ekskursionet. Gjatë *ekskursioneve*, nxënësit njihen me punën e makinave dhe të mekanizmave të prodhimit; si ato lehtësojnë punën e njeriut; marrin njohuritë e para për mekanizmin e prodhimit, për metodat e punës së mekanizuar, rregullin në punë dhe për profesione të ndryshme etj. *Për rritjen e interesit të nxënësve* për punë për të zgjeruar dhe për të thelluar njohuritë dhe shprehitë e fituara, është mirë të organizohen edhe punë jashtë klase, si: në zbulimin e korridoreve të shkollës, të oborrit, të kujdesen për lulishten e shkollës, të fshatit, të zonës ku banojnë, të komunitetit etj.

Në mënyrë të përmbledhur në mësimin e aftësimit teknologjik është e domosdoshme:

- Të respektohen me përpikëri parimet dhe rregullat didaktike;
- Në fillim të mësimin, nxënësve t'u tregohet qëllimi konkret i punës;

- Të zhvillohen tek nxënësit aftësitë logjike për të punuar, duke i nxitur të arsyetojnë gjatë punës;
- Të edukohen fëmijët me shprehinë e një pune të kulturuar, për të ngulitur tek ata ndjenjën e rregullit dhe të higjienës vetjake;
- T’i kushtohet rëndësi organizimit të punës kolektive me nxënësit (bashkëpunimi);
- Për t’ua zgjeruar horizontin politeknik, rëndësi të madhe ka krahasimi i mënyrave të punimit të një objekti në klasë dhe në prodhim;
- Për rritjen e interesit të nxënësve për punë, për zgjerimin dhe thellimin e njohurive dhe të shprehive të fituara, është mirë të organizohen edhe punë jashtë klase;
- Për zhvillimin normal të lëndës, rëndësi ka njohja e prindërve me punën që bëjnë fëmijët e tyre, si dhe që shkolla të ketë një minimum të caktuar pajimesh të nevojshme për realizimin e kërkesave të zbatimit të këtij programi.

VIII. VLERËSIMI I NXËNËSVE

Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që për çdo lloj pune nxënësit të marrin njohuritë e para praktike dhe teorike për punimin e objekteve, të mjeteve mësimore dhe të lodrave të thjeshta.

Të mbahet parasysh që në çdo orë mësimi vëmendja kryesore dhe koha t’i lihet punës së nxënësve. Pra teoria shërben vetëm për ta përgatitur nxënësin për të kryer punë të ndryshme. Në vlerësimin e nxënësit, mësuesi mbështetet në atë sa i ka realizuar nxënësi objektivat e temës përkatëse në krijimin e tij. Është e nevojshme që mësuesit të njohin dhe aftësitë e grup-moshës përkatëse për përcaktimin e objektivave të vlerësimit.

Vlerësimi bëhet me fjalë e shprehje sintetizuese, duke u mbështetur në punimet e secilit nxënës dhe konkretizohet me vendosjen e notës.